




**Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës**



Drejtoria për Administratë dhe Personel

Zyra e Prokurimit

Nr 03/ 24

Datë: 10.06, 2021.

KONTRATË PROKURIMI Nr.12

Komuna e Malishevës (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe

Ndërmarrja Tregtare Grafike Blendi O.P. me seli në Prishtinë me nr.biznesi : 810446072 (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për :

DEKORIMI I QYTETIT PËR FESTA ZYRTARE

me numër identifikues: **62500-21-2248-2-3-6/62500-21-033-236**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: DEKORIMI I QYTETIT PËR FESTA ZYRTARE.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me rastin e nënshkrimit dhe përfundon me kryerjen e dekorimit të qytetit për festa zyrtare.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se *[shëno numrin]* ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë: Në Qytetin e Malishevës.

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP² (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

² DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 3. **ÇMIMI**

3.1 Çmimi total i kontratës është : **2,428.00€** (me shkronja) :

(dymijëekatërqindënjëzetëetëeuro)Euro.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës.

Neni 3.3. **Menaxhimi i Kontratës**

Menaxhimin e Kontratës dekorimi i qytetit për festa zyrtare dota bëjë zyrtari i DSHP-së **z.Fadil Shala** i caktuar nga ZKA i AK-së.

Neni 3.4. **Obligimet e OE**

OE është i obliguar që dekorimin e qytetit për festa zyrtare ta kryej në përputhëshmëri të plotë me specifikacionin e ofertës. Dekorimi i qytetit për festa zyrtare duhet të kryhet në cilësi të kërkuar nga AK. Nëse Dekorimi i qytetit nuk kryhet në cilësi dhe sasi të kërkuar nga AK dhe në përputhëshmëri me specifikacionin e ofertës shpenzimet e bëra biejnë në llogari të operatorit ekonomik. OE nuk do të pranohen edhe shërbimet e kryera pa porosi të AK. Kontraktuesi i parë (AK) e ruan të drejtën që t'a ndërprej kontratën me kontraktuesin e dytë (OE) për mos realizimin e kontratës në cilësi dhe afatë .

Neni 3.5. **AFATI**

Dekorimi i qytetit për festa zyrtare do të kryhet në periudhën prej 24 muajsh që nga dita e nënshkrimit të kontratës. Njësia kërkuese përkatësisht menaxheri i kontratës çdoher duhet ti paraprij me një kërkesë drejtuar operatorit ekonomik për kryerjen e shërbimit së paku shtatë (7) ditë para datës të përcaktuar për festat zyrtare sipas specifikacionit të ofertës.

Neni 4. **PAGESA**

4.1. Pagesa do të bëhet në Euro.

4.2. Obligohet kontraktuesi i parë (AK) që pasi t'a pranon raportin e kryerjes së shërbimit nga zyrtari përkatës dhe faturën nga kontraktuesi i dytë (OE) t'ia paguaj shumën sipas neni. 3 dhe 3.1 të kësaj kontrate (pagesa kontraktuesit të dytë do të i bëhet në bazë të raportit të zyrtarit të caktuar nga ZKA i AK për menaxhim të kontratës).

4.3. Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet

llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5. Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6. Kualiteti

6.1 Kualiteti i shërbimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7. Garancioni

7.1. Garancioni do të mbetet valid për _____ muaj, pas pranimit të shërbimeve.

Neni 8. Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i kryej ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa realizuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9. Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10. Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11. Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12. Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.




13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [specifiko gjykatën kompetente] në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14. Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë. E hartuar në gjuhën **Shqipe** në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Operatorin Ekonomik

Emri:	Nuhi Shalaj	Emri:	Shaip Rama
Pozita:	Menaxher i Prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	08.06.2021	Data:	10.06.2021
Vula:		Vula:	

LISTA E QMIMEVE
SPECIFIKACIONI TEKNIK.

Nr	Përshkrimi i shërbimit	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi meTVS H	Totali me TVSH
1	Furnizim,vendosje dhe largim të flamujeve kombëtarë në qytet për festat : 17 Shkurti-Pavarësia e Kosovës. 5,6,7,Mars-Epopeja e UÇK-së. 16,Qershori-Dita e Çlirimit dhe Dëshmorëve . Festivali “Oda e Llapushës” . 28,Nëntori-Shpallja e Pavarsisë së Shqipërisë. -Flamujt duhet të jenë dhe vendosen sipse standartit të përcaktura me ligj (90 x 145 cm).	copë	150	3.8	570
2	Furnizim,vendosje dhe largim të flamujeve shtetëror në qytet për festat : 17 Shkurti-Pavarësia e Kosovës. 5,6,7,Mars-Epopeja e UÇK-së. 16,Qershori-Dita e Çlirimit dhe Dëshmorëve . Festivali “Oda e Llapushës” . 28,Nëntori-Shpallja e Pavarsisë së Shqipërisë. -Flamujt duhet të jenë dhe vendosen sipse standartit të përcaktura me ligj (90 x 145 cm).	copë	150	3.8	570
3	Furnizimi me flamuj kombëtarë me theka me dimensionet 170 x 300 cm.	copë	13	40	520
4	Furnizim,vendosje dhe largim të banerit (carad) me dimenezion:80 cm x 6 metra, për festën e 16 Qershorit në katër rrugët në hyrje të qytetit me shenimin:	copë	4	48	192

	URIME DITA E ÇLIRIMIT DHE E DËSHMORËVE!				
5	Furnizim,vendosje dhe largim të banerit (carad) me dimenezion: 80 cm x 6 metra , për festën e 17 Shkurtit në katër rrugët në hyrje të qytetit me shenimin: URIME 17 SHURTI !	copë	4	48	192
6	Furnizim,vendosje dhe largim të banerit (carad) me dimenezion: 80 cm x 6 metra , për festën e 28 Nentorit në katër rrugët në hyrje të qytetit me shenimin: URIME 28 NENTORI !	copë	4	48	192
7	Furnizim,vendosje dhe largim të banerit (carad) me dimenzion: 80 cm x 6 metra ,nga data 1 korrik deri me 31 gusht në katër rrugët në hyrje të qytetit me shenimin: MIRË SE VINI MËRGIMTARË !	copë	4	48	192
8	TOTALI				2428